

JETA NË FSHATIN ISNIQ PËRMES KUJTIMEVE
DHE FOTOGRAFIVE TË NJË NORVEGJEZEJE

Ann Christine Eek, "Jeta në fshatin shqiptar - Isniq, Kosovë 1976",
përkthyer nga Avni Spahiu, botoi: Tira Books, Suedi, 2021, 267 f.



Ann Christine Eek-u jeton në Norvegji dhe ka përvojë në punën e saj si fotografetare, fotografinë artistike, kritike dhe shkrimtare arti, por ka punuar edhe si fotografe në Muzeun Etnografik, i cili më vonë u bë pjesë e Muzeut të Historisë Kulturore të Universitetit të Oslos. Ky libër vjen si rezultat i ekspeditës së antropologes së njohur, Berit Backer-it, në fshatin Isniq të komunës së Deçanit, gjatë muajve gusht dhe shtator, ku qëndruan dhe bashkëjetuan me familjen Kukleci të këtij fshati. Por, Ann Christine Eek-u u kthye edhe disa herë pas përfundimit të luftës, por tani e vetme pasi antropologia Backer kishte vdekur në vitin 1993.

Librit i paraprin një parathënie e shkurtër nga studiuesja etnologe, Prof. dr. Afërdita Onuzi, e cila e

çmon lart punën e realizuar gjatë ekspeditës si dhe tregon rëndësinë që ka ky libër për trashëgiminë kulturore shqiptare. Libri i ka 267 faqe, të klasifikuara në këtë mënyrë: *parathënia; hyrja; udhëtimi jozyrtar në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë; Isniq-burrat janë fshati; prapa mureve të gurit - bota e gruas; kanagjeqi - nusja e ardhshme del nga shtëpia; dasma - pritja e nuses; vajtimi - ceremonia e zisë; kullat - shtëpitë e vjetra prej guri; familja Kukleci; familja Tahirsylaj; familja Tishukaj; largimi nga Isniqi në vitin 1976; kthimi pas luftës së vitit 1998-1999; Selim Kukleci; Berita - mikja norvegjeze e shqiptarëve; shënime mbi historinë e shqiptarëve të Kosovës, bibliografia e përzgjedhur.*

Libri është i ilustruar me rreth 300 fotografi, të shoqëruara me legjenda përshkrues. Duke pasur parasysh se që të dyja studiueset kanë jetuar në familje ato kanë pasur mundësi ta përcjellin zhvillimin e

gjithë jetës, dhe atë në të gjitha dimensionet dhe mënyrat se si është zhvilluar ajo, pa u ndier në siklet apo të penguar nga të tjerët. Të gjitha fotografitë ilustrojnë dhe përshkruajnë një proces të punës në fshat, zhvillimin e jetës, duke përfshirë ciklet e jetës, si martesën, vdekjen, por edhe momente të punës qoftë në fusha, qoftë brenda në ambientet e shtëpisë, qoftë në oborr, qoftë bjeshtë, gjithashtu përshkruhen edhe ndërtimi i shtëpisë, puna e bukëpjekësit, puna e dorës së grave, kujdesi ndaj fëmijëve, momentet e mësimin, ditët e tregut në Prizren, dyqanet e artizanëve/zejtarëve të ndryshëm, si: të djepave (drugdendjes), këpucarëve, punën në ambulante, pastaj procesin e përgatitjes së ushqimeve tradicionale, por edhe momentet e pushimit, peizazhet e ndryshme nga natyra e bukur. Disa fotografi janë realizuar edhe pas përfundimit të luftës, ku përmes tyre na paraqet shtëpi të dëmtuara, nëna të dëshmorëve, momente gëzimi gjatë martesës së djalit të kryefamiljarit, tek i cili kanë qëndruar në vitin 1976. Përveç fotografive libri është i pajisur edhe me harta të ndryshme.

Gjatë ekspeditës, bashkë me Berita Backer-in, Ann Christine Eek-u kishte realizuar me mijëra fotografi, shumë regjistrime qoftë me intervista, qoftë muzikë tradicionale. Duhet theksuar se Berita kishte shkuar të hulumtonte për tezën e saj të magjistraturës (gjatë viteve 1974-1975), që e kishte botuar më vonë

me titull, “Prapa mureve të gurit - ndryshimi i organizimit të familjes në mesin e shqiptarëve në Jugosllavi”, e cila është botuar në gjuhën angleze, në vitin 2003 Pejë dhe 2015 Londër.

Në pjesën “Isniqi –burrat janë fshati”, ajo fillimisht e përshkruan pozitën gjeografike të fshatit duke u ndaluar edhe për historinë e formimit të fshatit Isniq, organizimin dhe udhëheqjen e fshatit që nga shek. XV-XVI, përmes bajrakëve, fisit, Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke e çmuar mikpritjen dhe besën. Gjithashtu, në këtë pjesë, ajo e potencion numrin e madh të studentëve që kishte ky fshat.

Në pjesën e katërt “Prapa mureve të gurit - bota e gruas”, nga vetë titulli kuptohet se, gruaja në këtë kohë jetonte dhe vepronte brenda mureve, të cilat i rrethonin oborret e shtëpive, ndërsa kur dilte në rrugë për në vizita apo për punë të tjera, ajo gjithmonë shoqërohej nga një burrë, eventualisht grua plakë. Kjo tregon për mentalitetin patriarkal që zotëronte në atë kohë jo vetëm në këtë fshat, por në përgjithësi në Kosovë, sigurisht që më shumë ishte i theksuar në fshat. Ann Christine Eek-u tregon për punët e rënda që i bëjnë gratë, si: vënia e sanës, prerja e druve, kujdesin ndaj rritjes së fëmijëve, sigurimin e veshmbathjeve, duke punuar punë dore, larja e rrobave, pastaj tregon për shumë tradita të tjera që kishin të bënin me jetën e gruas, qoftë pas vdekjes së burrit, qoftë asaj që i punonte burri në

kurbet dhe ajo jetonte bashkë me fëmijët në familjen e madhe të bashkëshortit. Por, me fillimin e arsimimit të gruas, pra gjatë viteve '70, kishin filluar të ndryshonin gjërat në favor të gruas. Në pjesën e pestë dhe atë të gjashtë, e përshkruan ritin e martesës duke filluar me ritin e kanagjeqit, ku është ndalur edhe te martesat që realizoheshin pa pëlqimin e çiftit, por vetëm përmes familjes, e shpjegon edhe çështjen e martesës, sa i përket gjendjes materiale të dhëndrit, i cili i paguante shpenzimet për martesë ku negocihohej për shuma sa më të mëdha të cilat shërbenin për të blerë veshmbathje për burrë, për fëmijët që do të lindnin, ari, shtroja, mbuloja e gjëra të tjera të nevojshme për një familje. Ann Christine Eek-u e potencon se ky nuk ishte “çmim për nusen”, por një lloj sigurie për nusen dhe familjen e re që po krijohet. Vazhdon me dasmën, duke e përshkruar në pika të shkurtra ritin, që nga vendosja e flamurit në dritare, shkuarja për të marrë nusen, hyrja dhëndër, dita e grave. Pjesën e shtatë e ka titulluar “Vajtimi - ceremonia e zisë”. Anna Christine Eek-u na e përshkruan ritualin që ishte organizuar me rastin e vdekjes së një plaku të fshatit, ditën e varrimit, dhe vajtimin i cili ishte bërë një ditë pas varrimit. Autorja përshkruan vajtimin që bëhej nga një vajtoreshë e cila shquhej për këtë veprim, atë e shoqëronin gra të tjera të ulura në vendin ku ishin të ekspozuara veshjet dhe fotografitë e të vdekurit.

Përderisa gratë vajtonin dhe shprehnin dhembjen me vaj, te burrat dhembja shprehej pa vaj, ata dhimbjen e paraqisnin në mënyrë “më dinjitoze”. Pjesa e tetë është “Kullat - shtëpitë e vjetra prej guri”. Nga vetë titulli e kuptojmë se fokusi i autores është te kullat e gurit që janë karakteristikë e shumë fshatrave të Rrafshit të Dukagjinit edhe të Isniqit. Ajo, në pika të shkurtra, e paraqet kohën e ndërtimit, duke iu referuar studiuesve, të cilët janë marrë më herët me studimin e kullave, pastaj flet për organizmin e brendshëm të saj, odës në veçanti, të ndarë në baza gjinore, pra pjesën e burrave që, siç e thamë, ishte oda dhe pjesët e tjera të ndara për gra. Në tre kapitujt në vazhdim (kapitullin e nëntë, të dhjetin dhe të njëmbëdhjetin) flet për familjet Kukleci, Tahirsylaj dhe Tishukaj, duke u ndalur te subjektet (pjesëtarët) kryesorë apo që janë më reprezentativë të familjeve përkatëse. Ajo i përshkruan me shumë kujdes qoftë origjinën e familjes (për gratë e martuara) karakterin e tyre, mençurinë, afërsinë, por edhe rrugëtimin e përditshëm jetësor, qoftë, si gra, nëna, bashkëshorte, vjehrra, nuse, si dhe të burrave në të gjitha rolet e tyre, shoqërimin e subjekteve nga autorja edhe në bjeshkë ku dalin gjatë stinës së verës. Përmes rrëfimit, trajtimit të jetës personale të subjekteve, gra apo burra të këtyre tri familjeve. Ann Christine Eek-u paraqet në mënyrë kronologjike zhvillimin e familjes, duke e trajtuar në të gjitha aspektet, fillon me jetën per-

sonale, pastaj traditën, kulturën, (ritet), jetën sociale, zhvillimet historike etj. Përmes trajtimit të personazheve na e paraqet edhe diversitetin në mënyrën e jetës, kur flet për familjen e madhe që ndahet në familjen bërthamë, shpërnguljet e djemve nga fshati në qytet, ndryshimin në veshje.

Në pjesën e dymbëdhjetë “Largimi nga Isniq në vitin 1976” flet për largimin e tyre nga ky fshat, por edhe gjendjen në të cilën ishte fshati. Në pjesën e trembëdhjetë “Kthimi pas luftës 1998-1999”, Ann Christine Eek-u, tregon se falë rrethanave politike jo të mira për shqiptarët gjatë viteve '80 dhe '90, e kishte të pamundur që të kthehej në Kosovë, gjë që e bëri në korrik të vitit 2000. Ajo me syrin e saj të mprehtë, kishte vërejtur gjithë ndryshimet që ishin bërë qoftë në infrastrukturë pas djegies dhe shkatërrimit të Kosovës gjatë luftës, qoftë humbjet në njerëz në familjet ku ajo kishte qëndruar gjatë vitit 1976. Ajo këtu flet edhe një herë për tri familjet, Osdautaj, Kukleci dhe Tishukaj, tregon për humbjet e familjarëve, në vitin 1999 e 2013. Në këtë vizitë që kishte bërë Ann Christine Eek-u në Kosovë, nuk ishte ndalur vetëm në Isniq, por kishte realizuar vizita edhe në fshatra e qytete të tjera, si në fshatin Qyshk, Loxhë, në Prishtinë kishte takuar dhe biseduar me Adem Demaçin, me të cilin kishin bërë edhe disa vizita, në Kishën Katolike në Ulpianë, monumentin e Gazimestanit, tyrben e Sulltan Muratit I. Ann Christine Eek-

u, në vazhdim, flet edhe për vizitën e vitit 2001 në Kosovë, si dhe takimin me albanologët e Kosovës dhe e të Shqipërisë, gjatë një ekspeditë hulumtuese në Has, pjesën e Shqipërisë dhe të Kosovës. Gjatë kësaj ekspeditë njëjavore, bashkë me folkloristë, etnografë, antropologë etj., kishte pasur mundësinë të shihte grupe të ndryshme këngëtarësh, muzikantë e valltarë, të takonte krerë të besimit mysliman dhe katolik, kishte vizituar varreza të dëshmorëve të UÇK-së etj. Gjithashtu, kishin marrë pjesë në një dasmë të një familje katolike në Zym të Hasit. Në pjesën e katërbëdhjetë “Selim Kukleci”, ajo e trajton në mënyrë të veçantë familjen dhe figurën e Selimit, duke filluar nga rrënjët e kësaj familje, trashëgimtarët, duke qenë edhe vetë prezentë në gëzime familjare, si: dasma etj., dhe në fund vdekjen e Selimit, ku, po ashtu, kishte marrë pjesë në varrimin e tij dhe e kishte përcjellë edhe vajtimin e kishte bërë fotografi.

Pjesën e pesëmbëdhjetë, Anna ia kushton Berit Backer-it, të cilën e trajton në mënyrë kronologjike duke filluar nga lindja, për të vazhduar pastaj me arsimimin, punësimin, vizitat e saj në Shqipëri e Kosovë, aktivitetin e saj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, punën me emigrantë, vdekjen e saj, botimin e librit të saj e deri pas vdekjes kur edhe iu nda një mirënjohje nga shteti i Kosovës për kontributin e saj si luftëtare për mbrojtjen e të drejtave të

shqiptarëve, kontributin e saj si antropologe për kulturën shqiptare.

Në pjesën e gjashtëmbëdhjetë “Shënime mbi historinë e shqiptarëve të Kosovës” flet në mënyrë kronologjike për historinë që nga periudha e neolitit e deri në shpalljen e Kosovës shtet i pavarur. Ndërsa në pjesën e fundit e ka vendosur bibliografinë, të cilën e ka shfrytëzuar gjatë shkrimit të këtij libri.

Ky libër i Ann Christine Eek-ut ka shumë “jetë”, është vetë jeta e fshatit shqiptar të viteve '70, por, vetëm syri, veshi, vigjilenca, kujdesi i një artisteje mund t'i vërejë (t'i kapë) gjithë këto elemente, pavarësisht se ajo nuk ishte studiuese, ajo i paraqet zhvillimet jetësore në këtë libër tamam me qasjen e një antropologie. Rrëfimet e Anës, dialogu me gratë paraqesin një botë shpirtërore, herë të vrarë, herë të lënduar, herë të ngazëllyer, herë të pikëlluar, varësisht momenteve kur ajo ka bashkëbiseduar me ato gra, gjendjes së tyre emocionale, momentit të vështirë apo të gëzuar; paraqet raportin nuse - vjehërr, kumatë me kumatë, burrë - grua. Fotografitë e përfshira në këtë libër janë trashëgimi, kulturë, art, bartin shumë emocione, qoftë gëzimi e lumturie, qoftë frike, mjერიmi, varfërie, etj. çdo fotografi është një tregim, rrëfim më vete, janë mrekulli artistike.

Vlorë FETAJ-BERISHA

